

MERITA SAUKU BRUCI

**MARTIN CAMAJ DHE E FOLMJA ARBËRESHE E GREÇIT
(AVELLINO) POST CAMAJ.**

La nostra lingua

A Greci parliamo l'albanese, ma non sappiamo scriverlo.

*Esiste, però una grammatica e un libro di racconti popolari
nell'albanese di Greci.*

*Questi due lavori sono stati pubblicati dal professor Martin Camaj,
un glottologo dell'Università di Monaco.*

*Il professo Camaj è venuto a Greci proprio fare degli studi
sulla nostra lingua.*

*A Greci parliamo il dialetto toscano, cioè il dialetto usato
nell'Albania Meridionale, mentre nell'Albania
centro-settentrionale si parla il dialetto ghego.*

Sasso Michele, classe 5^{al}

Në shkurt të vitit 1971, pas një periudhe disavjeçare kërkimesh dialektologjike ne terren, në katundin Greçi (provinca e Avellinos, Itali) Martin Camaj boton në Firence studimin monografik *E folmja arbëreshe e Greçit në provincën e Avellinos* (La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino, Firenze, Leo S. Olschki Editore, MCMLXXI, 120 pp.)

¹ “Gjuha jonë. Në Greçi flasim gjuhën shqipe, por nuk dimë ta shkruajmë. Ka megjithatë një gramatikë për të folmen shqipe të Greçit dhe një libër me rrëfenja popullore. Këto dy punime janë botuar nga profesor Martin Camaj, një gjuhëtar i Universitetit të Mynihut. Profesor Camaj ka ardhur në Greçi me qëllim që të studiojë gjuhën tonë. Në Greçi flasim dialektin toskë, pra dialektin që përdoret në Shqipërinë e Jugut, kurse në Shqipërinë veriore e qendrore flitet dialekti gegë. Mikele Saso, nxënës i klasës V^{te}”. Ky shkrim është shkëputur nga një përmbledhje punimesh të hartuara nga nxënës të shkollës fillore të Mirabelës (Mirabella) dhe të botuar në formën e një gazete shkollë. Shih *Katundi die e sot – Greci ieri e oggi*, Delta 3 Edizioni, 2006, f.31.

Në këtë kumtesë mendojmë të trajtojmë, **përveç** shtysave që ndikuan mbi Camajn në zgjedhjen e studimit të së folmes së këtij komuniteti arbëresh, mënyrës se si e ka paraqitur këtë studim, rëndësisë së tij jo vetëm për Greçin, por edhe për studimet dialektologjike në lëmë të të folmeve arbëreshe në përgjithësi, **edhe** një vështrim krahasues mbi gjendjen demografike e gjuhësore të këtij komuniteti në kohën kur u shkrua monografia dhe sot, nevojat që ka ai për të ruajtur e transmetuar këtë pasuri gjuhësore të trashëguar si dhe projektet për të bërë të mundur një përpjekje të tillë, projekte që mbështeten fuqimisht mbi studimin e Camajt, dhe që e çojnë atë më tej.

Të folmet arbëreshe ruajnë tipare arkaike të shqipes dhe njohja e tyre, krahas studimit të gjuhës së shkrimtarëve arbëreshë, përbën një nga burimet e brendshme kryesore dhe me shumë vlerë për studimin e evolucionit historik të strukturës së shqipes. Zgjedhja e Greçit, apo Katundit, siç emërtohet e njihet në të folmen e vendasve, nuk qe një rastësi, por një nuhatje e hollë prej filologu, që në momentin e parë që merr kontakt me Greçin, në gusht të 1967. Greçi për Camajn studiues e filolog përmbushte të gjitha kërkesat për të qenë një objekt studimi i përshtashtëm. Gjeografikisht Greçi është i vendosur mbi një kodër, në një lartësi mesatare 700 m. mbi nivelin e detit dhe larg katundeve arbëreshe. Gjuhësisht, e fomja e Greçit është zhvilluar e veçuar, pasi nuk qarkohet e nuk është në kontakt me të folme të tjera arbëreshe, por vetëm me dialekte italiane dhe franko-provensale. Deri vonë banorët e tij janë marrë me bujqësi e blegtori dhe nuk kanë lëvizur. Edhe rrethi i informantëve të Camajt përbëhet nga më të moshuarit, kryesisht bujq dhe shtëpiake, “buoni conoscitori” (njohës të mirë - MB) të së folmes, siç i quan ai. Martesat kryesisht bëheshin brenda fshatit, por edhe në rastet kur nusja apo dhëndrri ishin nga fshatrat e afërta, komuniteti pritës i përthithte dhe ata mësonin gjuhën e vendit, aq sa, siç vëren dhe vetë Camaj: “edhe fëmijët e lindur nga martesat e përziera nuk dallojnë në të folur nga ata të lindur nga dy prindër shqiptarë vendas².”

I nxitur nga ndjeshmëria e pasioni prej gjuhëtari dhe shqetësimi prej intelektualit se kjo e folme ishte “in processo di estinzione” (në proces zhdukjeje - MB)³ Camaj zgjedh të hartojë dhe t’i kushtojë një monografi, me qëllimin që të japë një përshkrim të plotë të saj. Ndër shkaqet e shuarjes graduale të kësaj idiome ai rreshton komunikimin gjithnjë e më të

² “I figli nati da tali matrimoni misti non differiscono nel parlare da quelli nati da genitori albanesi del luogo”, [Camaj 71,4]

³ Shih [Camaj 71, 5]

dendur me komunitetet italiane fqinje, futjen e televizionit, prestigjin që ka gjuha italiane ndaj së folmes së vendit⁴.

Monografia prej 120 faqesh u drejtohet specialistëve të dialektologjisë dhe të gjuhësisë, shqiptarë e të huaj⁵. Për hartimin e saj Camaj u mbështet në monografi a studime me karakter dialektologjik të botuara deri në atë kohë dhe që kishin si synim përshkrimin dhe studimin e të folmeve të veçanta të krahinave të ndryshme brenda kufijve të Shqipërisë e jashtë saj⁶. Alfabeti i përdorur për transkriptimin e së folmes së Greçit, përfshirë këtu edhe shembujt e përdorur, tekstet ndihmës dhe fjalorin, është ai fonetik ndërkombëtar (IPA). Camaj ka synuar të japë një përshkrim të plotë të tipareve dalluese të së folmes në fjalë dhe të dokumentojë për aq sa ia kanë lejuar materialet e regjistruara rastet e përdorimeve. “Korpusi” gjuhësor është nxjerrë nga përralla apo “kunde” të ndryshme të regjistruara në Greçi në vitet 1966-1967, nga informantë të ndryshëm, si dhe nga përgjigjet e një pyetësori me mëse 3000 fjalë, që kanë lidhje kryesisht me leksikun

Dy ndarjet e mëdha, fonologjia e morfologjia, pasohen nga gjashtë përrallëza e tregime të shoqëruara edhe me përkthimin në italisht dhe nga një fjalës (glossario) me 846 njësi leksikore, edhe këto të dhëna në alfabetin fonetik ndërkombëtar dhe të shoqëruara me përkthimin italisht.

Kërkimet dhe regjistrimet e Camajt në fund të viteve ‘70 e që rezultuan me hartimin e një monografie, mbeten sot për sot studimi e përshkrimi më i plotë i përkushtuar krejtësisht së folmes së Greçit⁷.

⁴ “Fra le cause dello spegnersi graduale di questa parlata, oltre alla comunicazione intensa con gli altri villaggi limitrofi e alla televisione italiana che entusiasmo pure le vecchie, va annoverato anche “il prestigio” che gode la lingua italiana di fronte a un idioma “senza valore e strano” che sarebbe la parlata *a la ka’tunt*Σa. [Camaj 71, p.4]

⁵ Shih për këtë edhe [Ismaili 72] Rexhep Ismaili, Kritikë e recensione, *Gjurmime Albanologjike*, SSHF, I-1971, Prishtinë 1972, f.213-216.

⁶ Pasi përmend një sërë autorësh shqiptarë e të huaj që janë marrë me këto lloj studimesh për të folme të veçanta a grupe të folmesh të shqipes, si Desnickaja, Cimochoowski, Gjinari, Haxhihasani, Lafe, Kastrati, Domi, Shuteriqi, Totoni, Beci, Çeliku, Ajeti, Mulaku e Rohr, Camaj pohon se si udhërrëfyes e model më i mirë metodologjik për përshkrimet monografike të të folmeve të shqipes i ka shërbyer vepra e C. Haebler mbi të folmen shqipe të Akuaformozës (Kalabri) dhe ajo e Martines mbi të folmen franko-provensale (Hauteville, Savoie). [Camaj 71, p. 4-5]

⁷ Të tjerë që kanë shkruar: Università degli Studi di Salerno Addolorata Landi, “Per la storia linguistica di Greci- Il plurale in -ra” in *ZFB* 28,1/2, 1992, 61-64) Landi; Università degli studi della Basilicata, Facoltà di lettere e filosofia; Del

Ndër përpjekjet e tjera, ku kërkimet për këtë të folme kanë qenë pjesë e projekteve më të zgjeruara të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, asokohe në varësi të ASHRP, në kuadër të studimeve dialektore të mbarë shqipes, përfshi edhe të folmet arbëreshe, mund të përmendim ato për hartimin e Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe⁸, për botimin e të cilit komuna e Greçit lëvroi një kontribut të rëndësishëm financiar, si dhe një tjetër ekspeditë të kryer në dhjetor të vitit 1996⁹, nga Bahri Beci e Merita Bruci. Këto regjistrime të kryera në magnetofonë e të trashëguara në bobina apo kaseta, sot janë pjesë e arkivit zanor të QSA, që po dixhitalizohet për një ruajtje më afatgjatë e më cilësore.

40 vjet pas hartimit të monografisë, Greçi ka pësuar një ndryshim të madh demografik e shoqëror. Camaj paralajmëron: *Në dallim me shekullin e kaluar, jo vetëm që po zvogëlohet sasia e folësve, por edhe kompetenca gjuhësore, pa dyshim një faktor ky më domethënës sesa ai i numrit. Ajo që quhet "kompetencë pasive" pra aftësia vetëm për ta kuptuar gjuhën, përbën një tregues që brezi i ardhshëm do ta humbasë plotësisht njohjen e arbërishtes*¹⁰. Emigracioni ekonomik drejt qyteteve më të zhvilluara të Italisë dhe jashtë saj, rënia e numrit të martesave, rënia e numrit të lindjeve

Puente, Patrizia. "La parlata albanese di Greci: un'indagine in tempo reale." *L'Italia Dialettale* 57 (1994): 43-97.

⁸ Anketat që kanë paraprirë hartimin e atlasit janë zhvilluar gjatë një periudhe prej gjashtë vjetësh 1980-1985. Për 15 pikat e ngulimeve shqiptare të Italisë, ndër të cilat edhe Greçi, të dhënat janë mbledhur në anketa të bëra në vend nga anëtarë të grupit hartues të ADGJSH dhe nga regjistrime në magnetofon. Për Greçin informante është Maria Norcia 28 vjeç. Shih më hollësisht [Atlasi 07]: J. Gjinari, B. Beci, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani, *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe*, ASHSH, IGJL dhe Università degli Studi di Napoli "L'Orientale", Napoli, 2007 vëll. I 2008 vëll.II.

⁹ Informantët Francesco Meola 84 vjeç, Pasquale Martino 85 vjeç, Maria Meola 52 vjeç, Mario Martino 42 vjeç iu përgjigjën pyetjeve që kishin të bënin kryesisht me leksikun, por edhe shtjellimeve të cikleve të jetës, zakonit e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, apo veprimtarive të ndryshme të njeriut, duke filluar që nga punët në bujqësi e blegtori e deri tek festat e argëtimit gjatë vitit. Regjistrimet janë bërë me magnetofon profesional MARANTZ, mod. N. PMD430 dhe në kaseta SONY position CHROME C Dit II, 90 minutëshe.

¹⁰ "In confronto col secolo scorso, non solo va diminuendo la quantità dei parlanti, ma anche la competenza linguistica, fattore questo indubbiamente più significativo di quello del numero. La cosiddetta "conoscenza passiva", cioè la sola capacità di capire la lingua, è sintomo che la prossima generazione perderà del tutto la conoscenza del arbëresh". Shih: [Camaj 83, f.151]

kanë bërë që numri i banorëve sot të jetë rreth 900¹¹ (nga 2200 në kohën kur u shkrua monografia). Më anë tjetër, konstatohet një dobësim i rolit të aktorëve kryesorë të problemit gjuhësor arbëresh: mëmat e reja, që mendojnë se kohët kanë ndryshuar e që italishtja u vlen fëmijëve më shumë se arbërishtja (A. Giordano “*Ngaherë që lehet një djal arbëresh, atje luhet e ardhmja e arbëreshëve. Atje gjelbëron o kalbet rrënja arbëreshe.*”); prindër që flasin arbërisht ndërmjet tyre, por fëmijëve u flasin italisht, shkollimi në masë i fëmijëve dhe të rinjve në shkolla italiane, karakteri fakultativ dhe jodetyrues i mësimi të arbërishtes nëpër shkolla (ligji 482/99 u njeht të drejtën fëmijëve të mësojnë të lexojnë e të shkruajnë gjuhën e tyre, në shkollën e tyre, por u lihet në dorë prindërve të zgjedhin nëse fëmijët e tyre të mësojnë apo jo arbërisht në shkollë), ndjekja e televizionit, përdorimi i internetit nga të rinjtë.

“*Për sa na rezulton, e folmja e Greçit nuk ka një traditë të shkruar*” shkruante Camaj në monografinë e tij. Edhe sot, 40 vjet më pas ende nuk ka një **angazhim serioz shkencor** për të mundësuar shkrimin në këtë të folme. Por ka nisma e përpjekje modeste në nivel shkollor apo bashkiak, të përforcuara nga aprovimi i ligjit të shtetit italian për mbrojtjen e pakicave gjuhësore (L. 482/99), si dhe ai i regjionit të Kampanias (L. 14/2004). Bëhet fjalë për programe kulturore që synojnë shpëtimin, mbrojtjen dhe promovimin e gjuhës dhe të kulturës arbëreshe nëpërmjet kërkimeve apo kurseve formues për të rinj e të rritur. Do të përmendja këtu hartimin e fjalorit italisht-arbërisht e Greçit të titulluar *Fjalt Jona*¹² përmbledhjen *Katundi die e sot – Greci ieri e oggi*, Delta 3 Edizioni, 2006¹³; si edhe një tubë rrëfenjash, vjershash e recetash gatimi të titulluar *Ish një herë*¹⁴.

¹¹ Fillimisht në kuadër të provincës së Foxhas, e më vonë, pas 1860, me riorganizimin e Mbretërisë së Re të Italisë, si pjesë përbërëse e provincës së Avellinos Greçi numëronte më 1898 3868 banorë. Në 1920 kishte rreth 3200. Në regjistrimin e 1931 banorët e Greçit kapnin shifrën 2756. Regjistrimi më i fundit, i 1991, shënon një popullsi prej 1186 frymë, më 2000 kishte një popullsi prej 991 banorë. Një rënie e tillë demografike ka burimin tek emigracioni i madh ekonomik i viteve 1950-60 dhe tek rënia e numrit të lindjeve. (Burimi: Web site i komunës së Greçit <http://www.greci.org/storia.htm>)

¹² Centro Territoriale di Educazione Permanente, Scuola Secondaria Statale I grado “Aurelio Covotta di Ariano Irpino, – Comune di Greci, Provincia di Avellino, *Fjalt Jona*- Dizionario italiano - arbëresh di Greci, DELTA 3 Edizioni, 2004

¹³ I referohem botimit të përmendur në shënimin 1 të kesaj kumtese.

¹⁴ Scuola Secondaria Statale I grado “Aurelio Covotta di Ariano Irpino, Centro Territoriale di Educazione Permanente – Comune di Greci, Provincia di Avellino

Botime të këtij lloji janë një vlerë e shtuar dhe një tullë më shumë për të arritur rezultatin e kërkuar: përcjellja e identitetit historik e gjuhësor brezave të ardhshëm.

Si të gjitha vlerat e rëndësishme të së tashmes a të së kaluarës, kultura mbetet diçka aktuale, për t'u mbrojtur e për t'u kultivuar me pasion, për të përgatitur më mirë të ardhmen. Kjo varet edhe nga metodat apo format e përfitimit të produktit kulturor, që duhet të zgjojë kureshtjen dhe të lehtësojë përfitimin sidomos në mjediset shkollore. Që kjo traditë gjuhësore e kulturë e trashëguar të vazhdojë të udhëtojë nëpërmjet brezave, kërkohet një bashkërendim i përpjekjeve për një ndërgjegjësim të vetë komunitetit arbëresh dhe një bashkëpunim mes shkollave, mësuesve apo kultivuesve të gjuhës dhe universiteteve a qendrave kërkimore të specializuara.

Fryt i bashkëpunimit ndërmjet Katedrës së Gjuhës e Letërsisë Shqipe të Departamentit të Studimeve të Europës Lindore të Universitetit të Napolit "l'Orientale" dhe Komunës së Greçit është edhe një projekt kërkimi që synon të realizojë dhe të botojë një tekst multimedial, për të paraqitur të folmen e Greçit me shkrim, me zë dhe me imazh. Projekti *Greci: gjuha dhe kultura*, i propozuar, i ideuar dhe drejtuar nga prof. Italo Fortino do të realizohet nga një ekip specialistësh e teknikësh të këtij universiteti e të komunës së Greçit. Përveç gjuhës, një vend të rëndësishëm do të zërë edhe kultura, në këndvështrimin më të gjerë të saj: historia, letërsia, ritet fetare, muzika popullore. Qëllimi është të paraqesë strukturën e gjuhës së gjallë që ende sot flitet në Greçi, pra një prerje sinkronike që merr një rëndësi të veçantë për dokumentimin e fazës aktuale të gjendjes gjuhësore në këtë katund, por edhe me një vlerë të madhe praktike sa i përket didaktikës dhe përmbushjes së nevojave për të mësuar të shkruhet në atë të folme.

Gjuha që do të përdoret në tekstin e shtypur do të jetë e folmja e vendit dhe italishtja. Në pjesën e parë të tekstit shpjegimet do të jenë dygjuhëshe, për të shmagur çdo vështirësi në të kuptuar për ata që nuk zotërojnë shumë mirë të dyja kodet gjuhësore. Vetëm më pas, gradualisht, do t'i lihet vend së folmes së Katundit, edhe për shpjegimet e kategorive gjuhësore e, më pas, edhe për kulturën në një kuptim më të gjerë, por tanimë të shoqëruara nga një përmbledhje në italisht.

Paraqitja e sistemit alfabetik do të mundësonte shkrimin e së folmes që deri më sot ka mbetur akoma në nivel gojor.

Paraqitja e shkronjave të *alfabetit* do të ndahet në tri seksione, duke respektuar parimin didaktik të shkallëzimit të vështirësisë së nxënies së njohurive, nga më e thjeshta tek më e ndërlikuara: a) në ato që përkojnë si fonema e grafema me italishten standarde; b) fonema të pranishme në të dyja gjuhët por që realizohen me grafema të ndryshme; c) grafema të pranishme vetëm në shqipe.

Çdo foneme dhe grafemave me të cilat realizohet ajo në të shkruar, do t'u bashkëngjitet edhe realizimi zanor. Kjo është risia!

Ky studim fiton kështu edhe aspektin e një loje tërheqëse, ku nxënësi ndihet edhe protagonist dhe i jepet mundësia edhe për një vetëverifikim të shqiptimit dhe të diksionit të duhur.

Nga ana tjetër, falë teknikës së përdorur, respektimit të kriterëve shkencorë gjatë regjistrimeve, cilësisë dhe precizionit me të cilin do të kryhen, këto regjistrime do të shërbejnë si një bazë e mirë të dhënash edhe për studime dialektologjike, në aspektin diakronik brenda të njëjtës së folme, si edhe në atë krahasues në përjasje me të folme të tjera arbëreshe apo me shqipen e përgjithshme.

Të gjitha kategoritë gramatikore (emri, mbiemri, përemri, folja dhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës) do të paraqiten me shkrim, me shpjegime dygjuhëshe të bashkëshoqëruara edhe me zë dhe me figurë. Shembujt ilustrues do të shpëputen nga regjistrimet e bëra në terren, jo vetëm nga përgjigjet e pyetësorit, por edhe nga *përrallëzat o kundet* dhe do të kenë edhe imazhin e vendasve që i shqiptojnë paralelisht me zbardhjen e asaj çka kumtojnë.

Teksti parashikon edhe një panoramë të kulturës arbëreshe të Greçit.

Rubrika *Historia* do të trajtojë argumente më të përgjithshme që lidhen me dyndjen e osmanëve në Ballkan, figurën e Skënderbeut, emigrimet e ndryshme drejt Italisë në Mbretërinë e Napolit, si dhe aspekte më të veçanta, që lidhen drejtpërdrejt me ngulimet e para shqiptare në Greçi dhe historikun e Katundit.

Letërsia popullore dhe ajo e kultivuar, në vargje a në prozë, do të jetë e pranishme në një vështrim të përgjithshëm, duke u dhënë përparësi krijimeve popullore apo veprave letrare të autorëve me origjinë nga Katundi. Fragmentet e zgjedhura për ilustrim do të jepen në versionin origjinal, me përkthimin italisht, sipas traditës së njohur të krijuesve arbëreshë, të recituara nga vendas.

Personazhet historikë më të njohur, autorë vendas, prania dhe humbja e ritit bizantin dhe latinizimi i komunitetit arbëresh të Greçit në gjysmën e dytë të shekullit XVII, doke e zakone të lindjes, martesës dhe vdekjes, festat fetare apo kalendarike; momente të jetës së përditshme, punët në

bujqësi, blegtori a ndërtim, puna në tezgjah, gatimet, trashëgimia muzikore dhe pjesë të përzgjedhura të transkriptuara në pentagram, **shkurt** gjithçka që mund dhe duhet të dokumentohet, të mbrohet e të promovohet, është pjesë e synimeve të këtij projekti.

Është e natyrshme se për të mbrojtur jo vetëm që duhet të njohësh, por edhe të dish ta konsolidosh një identitet, që është pazgjidhshmërisht i lidhur me kulturën e traditës Qëllimi është të transmetosh vlera të kulturës që mund të bëhen gjithnjë e më shumë modele të ruajtjes së identitetit të një komuniteti.

BIBLIOGRAFIA

- [Atlasi 07]: J. Gjinari, B. Beci, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani, *Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe*, ASHSH, IGJL dhe Università degli Studi di Napoli "L'Orientale", Napoli, 2007 vëll. I 2008 vëll.II.
- [Camaj 71] Martin Camaj, *La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino*, Firenze, Leo S. Olschki Editore, MCMLXXI, 120 pp.)
- [Camaj 83] M. Camaj, "Per una tipologia dell'arbëresh", në *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia*, Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 25-28 novembre 1981, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese – Università di Palermo, Palermo, 1983, p.151-158.
- Centro Territoriale di Educazione Permanente, Scuola Secondaria Statale I grado "Aurelio Covotta di Ariano Irpino, – Comune di Greci, Provincia di Avellino, *Fjalt Jona-* Dizionario italiano - arbëresh di Greci, DELTA 3 Edizioni, 2004
- [Ismaili 72] Rexhep Ismaili, Kritikë e recensione, *Gjurmime Albanologjike*, SSHF, I-1971, Prishtinë 1972, f.213-216.
- Katundi die e sot – Greci ieri e oggi*, Delta 3 Edizioni, 2006
- Scuola Secondaria Statale I grado "Aurelio Covotta di Ariano Irpino, Centro Territoriale di Educazione Permanente – Comune di Greci, Provincia di Avellino
- Ish një herë* – Antologia grecese, DELTA 3 Edizioni, 2008.